

KUJDES! MOS DËMTO BARKODIN

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA QENDRORE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2009

SESIONI I

(I DETYRUAR)

VARIANTI A

E martë, 2 qershor 2009

Ora 10.00

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme e gjuhëve të huaja – seksioni dygjuhësh

Udhëzime për nxënësin

Testi është i ndarë në dy pjesë: në poezi dhe në tragjedi.

Testi në total ka **25 pyetje**.

Në të dy pjesët ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**. Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Koha për zhvillimin e kërkesave të testit është **2 orë e 30 minuta**.

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|-----|----|----|-----|-----|-----|-----|
| Kërkesa | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9a | 9b | 10a | 10b | 11a | 11b |
| Pikët | | | | | | | | | | | | | | |
| Kërkesa | 12a | 12b | 12c | 13a | 13b | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21a | 21b |
| Pikët | | | | | | | | | | | | | | |
| Kërkesa | 22 | 23a | 23b | 24 | 25a | 25b | 25c | 25d | | | | | | |
| Pikët | | | | | | | | | | | | | | |

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

PJESA I**Lasgush PORADECI****Poradeci**

Perëndim i vagëlluar mbi Liqerin pa kufir.
 Po përhapet dal-nga-dale një pluhurë si një hije.
 Nëpër Mal e nër Lëndina shkru mb' i natës që po bije,
 Dyke zbritur që nga qjelli përmbi fshat po bëhet fir...

E kudo krahin' e gjerë më s'po qit as pipëlim:
 Në Katund kërcet një portë...në Liqer heshtë një lopatë...
 Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal-të- Thatë...
 Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit t'im.

Tërë fisi, tërë jeta, ra...u dergj...e zuri gjumi...
 Zotëroj më katër anë errësira...

Po tashi:

Dyke nisur udhëtimin mes-për-mes nër Shqipëri,
 Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumi.

*Për pyetjet 1-7 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.*

1. Lirika e Lasgushit i përket letërsisë:

1 pikë

- A) humaniste shqiptare
- B) klasike shqiptare
- C) moderne shqiptare
- D) së vjetër shqiptare

2. Ideja e lëvizjes dhe jetës që s'vdes kurrë, në këtë poezi, konkretizohet në imazhin që krijon:

1 pikë

- A) lumi në udhëtimin e tij të pandërprerë.
- B) liqeni i përmasave pa kufi.
- C) madhështia e maleve dhe e lëndinave.
- D) zemra djaloshare por e trazuar e poetit.

3. Antonimi të kontekstit poetik krijon çifti: **1 pikë**
- A) plak – i përrallshëm
B) natë – errësirë
C) ra – u dergj
D) hesht - kërcet
4. *Perëndim i vagëlluar* ka kuptimin: **1 pikë**
- A) perëndim i ndritur
B) perëndim i qetë
C) perëndim i kuq
D) perëndim i mjegullt
5. Kjo poezi është shkruar me varg: **1 pikë**
- A) 13 rrokësh
B) 14 rrokësh
C) 15 rrokësh
D) 16 rrokësh
6. Në cilin prej vargjeve, përmes një shkallëzimi zbritës, grupi i foljeve jep idenë e qetësisë? **1 pikë**
- A) Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal-të- Thatë...
B) Tërë fisi, tërë jeta, ra...u dergj...e zuri gjumi...
C) E kudo krahin' e gjerë më s'po qit as pipëlim:
D) Në Katund kërcet një portë...në Liqer heshtë një lopatë...
7. Cili nga vargjet e mëposhtëm ka një rend të përmbysur sintaksor? **1 pikë**
- A) Tërë fisi, tërë jeta, ra...u dergj...e zuri gjumi...
B) Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumi.
C) Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal-të- Thatë...
D) Nëpër Mal e nër Lëndina shkrumb' i natës që po bije
8. Përshkruani atmosferën që krijohet në dy strofat e para të kësaj poezie. **1 pikë**
-
-
9. Me ç' pjesë të ligjëratës janë formuar metaforat e mëposhtme?
- a) shkrumb' i natës: _____ **1 pikë**
- b) jeta u dergj: _____ **1 pikë**

10.

- a) Ç'përftyrim krijon aliteracioni dhe reticënca në vargjet e mëposhtme? **2 pikë**

Tërë fisi, tërë jeta, ra...u dergj...e zuri gjumi...

Zotëroj më katër anë errësira...

- b) Fjala *errësira*, në këto vargje mund të interpretohet në dy mënyra: të drejtpërdrejtë dhe të figurshme. Si e kuptoni secilën prej tyre?

2 pikë

e drejtpërdrejtë: _____

e figurshme: _____

11.

- a) Dy vargjet e fundit krijojnë kontrast me pjesën tjetër të poezisë. Cili është thelbi i tij dhe si do ta interpretonit këtë kundërvënie?

2 pikë

- b) Me çfarë lidhet shqetësimi dhe dhimbja e poetit në këto vargje?

1 pikë

12. Cilës pjesë të ligjëratës i përket fjala *i përrallshëm*? Si është formuar ajo?

Zbuloni efektin e shprehësisë që krijon kjo fjalë.

- a) pjesa e ligjëratës: _____ **1 pikë**

- b) formimi: _____ **1 pikë**

- c) efekti i shprehësisë: _____ **1 pikë**

13. Disa emërtime të përgjithshme vendore poeti i shkruan me shkronjë të madhe.

Gjeni dy prej tyre dhe tregoni arsyen e një përdorimi të tillë.

- a) emërtimi 1: _____ **2 pikë**

emërtimi 2: _____

- b) arsyeja e përdorimit: _____ **1 pikë**

PJESA II**SHEKSPIR****Makbeth (fragment)****MAKBETHI**

Sikur të bëhej dhe të merrte funt do të ishte
mirë

Të ish bërë sa më shpejt. Sikur kjo vrasje
Të përjashtonte çdo pasojë dhe të kapte
Suksesin me mbarimn' e saj, sikur kjo vepër
Një herë e mirë hesapn' e saj ta mbyllte
Pa lënë bisht e gjurmë e hie pas
Këtu, vetëm këtu, mbi këtë dhé-
Në këtë buzëdet të cekët provizor-
Nuk e peshonim jetën tjetër fare.
Po kemi gjyq këtu për këto punë:
Se posa bëhemi mësonjës për gjakderdhje,
Na shembin me mësimet tona nxënësit;
Kjo drejtësi me dorë të paanëshme
Na zgjat në buzë vrerin që gatitëm vetë.
Ndodhet këtu dy herë i garantuar:
E para, e kam prind dhe e kam mbret,
Që e prapsin veprën që të dyja fort;
Pastaj, e kam këtu si mysafir;
Duhet ta mbronj prej vrasësve pra unë
Jo unë të ngre thikën kundër tij.
Përveç këtyre, ka qënë aqë i ëmbël,
Ka qeverisur shtetin aqë pastër
Sa mirësitë e tij, si ëngjëj me trumbetë,
Do t' ma dënojnë vrasjen e mallkuar.
Mëshira, si një foshnjë e posalindur,
Mbi krahët e furtunës dhe e hipur
Mbi kuaj të padukur Qerubinësh
Ka për të çfryrë në çdo sy njeriu
Tmerrin e veprës sime të pabesë
Dhe do ta mbyttë erën me shi lotësh.
S'kam yzengji ta çpoj qëllimin tim
Përveç ambicjes kulmëse që turret,
Që hidhet ca më tej se ç'i përket
Dhe bie në anën tjetër e përmbysur.

(Hyn Zonja Makbeth)

Eh, ç' kemi?

ZONJA MAKBETH

Pothua mbaroi darkën. Pse na ike?

MAKBETHI

A më kërkoi?

ZONJA MAKBETH

S' e di që të kërkoi?

MAKBETHI

Më tej s' duhet ta ngasim këtë punë.
Më ka nderuar fort tani në fund
Dhe kam fituar një respekt të artë
Në sy të gjithë botës; këtë rrobë
Të ndriçime duhet ta mbaj tani
E jo ta hedh mënjanë kaqe shpejt.

ZONJA MAKBETH

A ish e dehur shpresa ku m' u veshe?
A të ka fjetur dhe tani t' u zgjua
Dhe sheh, e zbetë, gjënë që e gëzoi?
Kështu tani ta di dhe dashurinë.
Në veprë në kurajë gjithashtu
Siç je dhe në dëshirë? Do ta kesh
Atë që quan si stoli të jetës
Dhe prapë rron frikaç në sy të vetes
Dhe po më thua "Dua, po s' guxoj"
Si macja delikate e proverbit?

MAKBETHI

Të lutem, hesht. Guxoj të bëj çdo gjë
Që i ka hie burrit; kush guxon
Më tepër s' është burrë.

ZONJA MAKBETH

Ahere, cili djall të shtyri vallë
Të bisedosh me mua këtë punë?
Kur deshe që ta bëje, ishe burrë;
Dhe ca më tepër burrë do të jesh
Kur të guxosh ta bësh me të vërtetë
Një herë as koha as vendi nuk ujdin
Dhe deshe t' i shtrëngoje të të ndihnin,
Tani që të ardhën vetë dhe të luten,
Pazotësia jote i largon.
Kam qënë nënë, e di sa është e dashur
Foshnja që më thëthin në krahëror:
Po prap, atje tek të m' i qeshte syri,

Ia çkulja gojën që prej thithit tim
Dhe e vërvitja kokë- tatëpjetë,
Sikur të kisha bërë be si ti.

MAKBETHI

Po në na daltë keq, -

ZONJA MAKBETH

Në daltë keq!
Vidhos kurajën mun në vend ku ngjitet
Dhe s'na del keq. Posa ta zërë gjumi,
Dhe gjumë i rëndë si pas lodhjes sotme,
Ia deh me verë e barra të dy shambellanët,
Ua bëj trutë tym e kokët trokë,
Dhe kur të shtrihen e të flenë derrërisht
Në pellg të gjumit, si në varr të vdekjes,
Ç'gjë s'bëjmë dot atëherë ti dhe unë
Mbi mbretin Dunkan të paruajtur?
Dhe pse të mos ua ngarkojmë vallë
Këtyre oficerëve të dehur
Fajin e madh të vrasjes sonë?

MAKBETHI

Bëj vetëm djem, moj grua.
Se trimëria jote e patrembur
S' duhet të lindë tjetër veç meshkuj. –
Po bota a do të besojnë vallë
Që e kanë vrarë ata që e ruajnë,
Si të përdorim kamat e atyre
Dhe si t'i ngjyejmë me gjak të dy?

ZONJA MAKBETH

Kush ka kurajën të besojë ndryshe,
Kur të bërtasim e të çirremi
Dhe të vajtojmë që na vdiq këtu?

MAKBETHI

E kam vendosur dhe tani tendos
Për veprën e tmerruar gjithë nervat.
Pra, shkojmë e buzëqeshur i gënjejmë;
Se faqe e rreme fsheh në zemër ç'ndejmë.

(Dalin)

Për pyetjet 14-19 rrethoni **vetëm** shkronjën që i përgjigjet alternativës së saktë.

14. Në monologun në fillim të kësaj scene Makbethi shfaqet:

1 pikë

- A) euforik
- B) i qetë
- C) i pasigurt
- D) nervoz

15. Ç'arsye jep Makbethi për të mos e vrarë mbretin Dunkan?

1 pikë

- A) Dunkani nuk mund të vdesë i ri.
- B) Dunkani është miku i tij.
- C) Dunkani është kushëriri i tij.
- D) Dunkani është më i fortë se ai.

16. Me vargun *Në këtë buzëdet të cekët provizor* Makbethi nënkupton:

1 pikë

- A) në këtë pjesë toke të Anglisë së vjetër.
- B) në këtë tokë ku jeta është kaq e shkurtër.
- C) në këtë ferr ku po jetojmë.
- D) në këtë tokë të ashpër dhe armiqësore.

17. Gjatë dialogut Makbethi i thotë Zonjës Makbeth: "*Të lutem, hesht*". Pse e bën ai këtë?

1 pikë

- A) Nuk e duron dot tonin e saj.
- B) Do t'i tregojë se burri është ai.
- C) Ka frikë t'i dorëzohet tundimit të brendshëm.
- D) Ka frikë se mos po i përgjojnë.

- 18.** Figura e stilistikës në vargun *Vidhos kurajën mun në vend ku ngjitet* është: **1 pikë**
- A) alegoria
B) metafora
C) metonimia
D) sinekdoka
- 19.** Për çfarë e akuzon Zonja Makbeth të shoqin? **1 pikë**
- A) Ai është një ushtar i dobët.
B) Ai është një frikacak.
C) Ai është një bashkëshort jokorrekt.
D) Ai është një baba i keq.
- 20.** Në një moment të kësaj skene te Makbethi shfaqet një anë e mirë e ndërjegjes së tij për të mos e vrarë mbretin Duncan. Cilat janë arsyet që e çojnë atë në një vendim të tillë? Identifikoni tri prej tyre. **3 pikë**
- a) _____
b) _____
c) _____
- 21.** Si reagon Zonja Makbeth ndaj të shoqit, kur dëgjon vendimin e tij? Gjeni një epitete që ajo i vendos atij? **1 pikë**
- a) reagimi: _____ **1 pikë**
- b) epitete: _____ **1 pikë**
- 22.** Cili është imazhi më i fuqishëm dhe ekstrem, me të cilin Zonja Makbeth mendon se do ta detyrojë të shoqin të veprojë? Ç’regon kjo për karakterin e saj? **2 pikë**
- _____

- 23.** Kur Makbethi ka frikë se do të dështojnë me vrasjen, e shoqja i parashton atij një plan për ta bindur se do të kenë sukses. Renditni tri etapat nëpër të cilat ky plan do të kalojë. **3 pikë**
- a) etapa I: _____
etapa II: _____
etapa III: _____
- b) Në cilin moment të kësaj skene Zonja Makbeth triumfon në betejën e saj me të shoqin? **1 pikë**
- _____

- 24.** Në mbyllje të skenës Makbethi thotë: “*Pra, shkojmë e buzëqeshur i gënjejtmë;/ Se faqe e rreme fsheh në zemër ç’ndjejmë*”. Nisur nga këto fjalë, shpjegoni si shfaqet ai në këtë moment. **2 pikë**
- _____

25. Argumentoni në formën e një eseje deri në ç' masë Zonja Makbeth është fajtores për rënien e të shoqit. Në përgjigjen tuaj referojuni marrëdhënieve të çiftit në këtë skenë dhe përgjatë tragjedisë.

8 pikë

| Shtjellimi i idesë (25a) | Organizimi dhe struktura (25b) | Stili dhe origjinaliteti (25c) | Saktësia gjuhësore (sintaksa dhe drejtshkrimi) (25d) | Totali |
|--------------------------|--------------------------------|--------------------------------|--|---------------|
| 2 pikë | 2 pikë | 2 pikë | 2 pikë | 8 pikë |
| | | | | |